Raporti: PBAS - Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik

NUQV: 130 - Bashkia Malësi e Madhe

PBA: 2025 - 2027

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

|                                         |           | 2025   |      |                   |     |     |     |     |       |     |     |                      |     |     |     |                      |         |  |       |
|-----------------------------------------|-----------|--------|------|-------------------|-----|-----|-----|-----|-------|-----|-----|----------------------|-----|-----|-----|----------------------|---------|--|-------|
| EMËRTIMI I PROGRAMIT                    | PERSONELI |        |      | KORRENTE TË TJERA |     |     |     |     |       |     |     | KAPITALE TËBRENDSHME |     |     |     | KAPITALE TË<br>HUAJA |         |  | PLANI |
|                                         | 600       | 601    | 1661 | 602               | 603 | 604 | 605 | 606 | 609   | 651 | 230 | 231                  | 232 | 255 | 230 | 231                  | 232     |  |       |
| 06370 - Furnizimi me Uje dhe Kanalizime | 0         | 0      | 0    | 0                 | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0                    | 0   | 0   | 0   | 0                    | 0       |  |       |
| Totali                                  | 381,295   | 63,336 | 0    | 171,090           | 0   | 0   | 0   | 0   | 4,000 | 0   | 0   | 169,095              | 0   | 0   | 0   | 0                    | 788,816 |  |       |


**Raporti: PBA5 - Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik**

NUVOV: 130 - Bashkia Malësi e Madhe

PBA: 2025 - 2027

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

| EMËRTIMI I PROGRAMIT                                                            |         | PERSONELI |     | KORRENTE TË TJERA |     |     |     |     |     |       |     |     |     | KAPITALE TË BRENDSHME |     |     |     | KAPITALE TË HUAJA |         |  |  | PLANI |
|---------------------------------------------------------------------------------|---------|-----------|-----|-------------------|-----|-----|-----|-----|-----|-------|-----|-----|-----|-----------------------|-----|-----|-----|-------------------|---------|--|--|-------|
|                                                                                 |         | 600       | 601 | 1661              | 602 | 603 | 604 | 605 | 606 | 609   | 607 | 230 | 231 | 232                   | 255 | 230 | 231 | 232               |         |  |  |       |
| 01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                                 | 143,897 | 24,031    | 0   | 66,482            | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0   | 0                     | 0   | 0   | 0   | 0                 | 244,410 |  |  |       |
| 03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile                                 | 23,671  | 3,953     | 0   | 18,326            | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0   | 0                     | 0   | 0   | 0   | 0                 | 45,950  |  |  |       |
| 04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëveit | 8,990   | 1,502     | 0   | 932               | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0   | 0                     | 0   | 0   | 0   | 0                 | 11,424  |  |  |       |
| 04240 - Menaxhimi i ujës dhe kullimit                                           | 7,385   | 1,234     | 0   | 9,738             | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0   | 0                     | 0   | 0   | 0   | 0                 | 18,357  |  |  |       |
| 04260 - Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave                                        | 24,117  | 4,027     | 0   | 5,114             | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0   | 0                     | 0   | 0   | 0   | 0                 | 33,258  |  |  |       |
| 03140 - Shërbimet e Policisë Vendore                                            | 10,760  | 1,797     | 0   | 2,039             | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0   | 0                     | 0   | 0   | 0   | 0                 | 14,596  |  |  |       |
| 04520 - Rrjeti Rrugor Rural                                                     | 21,099  | 3,524     | 0   | 12,226            | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0   | 67,700                | 0   | 0   | 0   | 0                 | 104,549 |  |  |       |
| 06260 - Shërbimet Publike Vendore                                               | 16,033  | 2,337     | 0   | 7,869             | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0   | 0                     | 0   | 0   | 0   | 0                 | 26,239  |  |  |       |
| 08130 - Sport dhe argëtim                                                       | 4,127   | 689       | 0   | 13,841            | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0   | 37,253                | 0   | 0   | 0   | 0                 | 55,910  |  |  |       |
| 08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat               | 0       | 0         | 0   | 7,372             | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0   | 0                     | 0   | 0   | 0   | 0                 | 7,372   |  |  |       |
| 09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollorollorin)           | 75,657  | 12,635    | 0   | 23,243            | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0   | 23,745                | 0   | 0   | 0   | 0                 | 135,280 |  |  |       |
| 09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm                                           | 12,362  | 2,065     | 0   | 11,450            | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0   | 19,133                | 0   | 0   | 0   | 0                 | 45,010  |  |  |       |
| 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët                                 | 13,414  | 2,240     | 0   | 0                 | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0   | 0                     | 0   | 0   | 0   | 0                 | 15,654  |  |  |       |
| 05100 - Menaxhimi i mbetjeve                                                    | 24,266  | 4,052     | 0   | 22,200            | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0   | 0                     | 0   | 0   | 0   | 0                 | 50,518  |  |  |       |
| 04130 - Mbështetje për zhvillimin ekonomik                                      | 3,537   | 591       | 0   | 2,303             | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0   | 0                     | 0   | 0   | 0   | 0                 | 6,431   |  |  |       |
| 04910 - Fondi Rezerve                                                           | 0       | 0         | 0   | 0                 | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 2,000 | 0   | 0   | 0   | 0                     | 0   | 0   | 0   | 0                 | 2,000   |  |  |       |
| 04940 - Fondi Kontigjence                                                       | 0       | 0         | 0   | 0                 | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 2,000 | 0   | 0   | 0   | 0                     | 0   | 0   | 0   | 0                 | 2,000   |  |  |       |



Raportit: PBA5 - Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik

NUVOV: 130 - Bashkia Malësi e Madhe

PBA: 2025 - 2027

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

|                                         |           | 2026              |     |         |     |     |     |     |     |       |     |                      |     |     |     |                   |     |         |  |       |
|-----------------------------------------|-----------|-------------------|-----|---------|-----|-----|-----|-----|-----|-------|-----|----------------------|-----|-----|-----|-------------------|-----|---------|--|-------|
| EMËRTIMI I PROGRAMIT                    | PERSONELI | KORRENTE TË TJERA |     |         |     |     |     |     |     |       |     | KAPITALE TËBRENDSHME |     |     |     | KAPITALE TË HUAJA |     |         |  | PLANI |
|                                         |           | 600               | 601 | 1661    | 602 | 603 | 604 | 605 | 606 | 609   | 651 | 230                  | 231 | 232 | 255 | 230               | 231 | 232     |  |       |
| 06370 - Furnizimi me Uje dhe Kanalizime | 0         | 0                 | 0   | 0       | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0                    | 0   | 0   | 0   | 0                 | 0   | 0       |  |       |
| Totali                                  | 389,315   | 64,677            | 0   | 203,135 | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 4,000 | 0   | 157,831              | 0   | 0   | 0   | 0                 | 0   | 818,958 |  |       |



**Raporti: PBA5 - Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik**

NUVOV: 130 - Bashkia Malësi e Madhe

PBA: 2025 - 2027

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

| EMËRTIMI I PROGRAMIT                                                          | 2027      |        |      |                   |     |     |     |     |       |     |     |        |     |     |     |     |     |     |         |
|-------------------------------------------------------------------------------|-----------|--------|------|-------------------|-----|-----|-----|-----|-------|-----|-----|--------|-----|-----|-----|-----|-----|-----|---------|
|                                                                               | PERSONELI |        |      | KORRENTE TË TJERA |     |     |     |     |       |     |     |        |     |     |     |     |     |     |         |
|                                                                               | 600       | 601    | 1661 | 602               | 603 | 604 | 605 | 606 | 609   | 651 | 630 | 231    | 232 | 233 | 234 | 235 | 236 | 237 | 238     |
| 01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi                               | 144,359   | 24,109 | 0    | 67,211            | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 10,900 | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 245,679 |
| 03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile                               | 23,671    | 3,953  | 0    | 18,326            | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0      | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 45,950  |
| 04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve | 8,990     | 1,502  | 0    | 932               | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0      | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 11,424  |
| 04240 - Menaxhimi i ujës dhe kullimit                                         | 7,533     | 1,258  | 0    | 9,738             | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0      | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 18,529  |
| 04260 - Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave                                      | 23,260    | 3,884  | 0    | 5,114             | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0      | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 32,258  |
| 03140 - Shërbimet e Policisë Vendore                                          | 10,760    | 1,797  | 0    | 2,039             | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0      | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 14,596  |
| 04520 - Rrjeti Rrugor Rural                                                   | 21,099    | 3,524  | 0    | 12,226            | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 96,493 | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 133,342 |
| 06260 - Shërbimet Publike Vendore                                             | 16,033    | 2,337  | 0    | 7,869             | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0      | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 26,239  |
| 08130 - Sport dhe argëtim                                                     | 4,127     | 689    | 0    | 13,841            | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 37,253 | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 55,910  |
| 08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet, muze të dhe bibliotekat            | 0         | 0      | 0    | 7,372             | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0      | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 7,372   |
| 09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollorollorin)         | 75,657    | 12,635 | 0    | 23,243            | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 23,745 | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 135,280 |
| 09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm                                         | 12,609    | 2,106  | 0    | 10,721            | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 19,133 | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 44,569  |
| 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët                               | 13,414    | 2,240  | 0    | 0                 | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0      | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 15,654  |
| 05100 - Menaxhimi i mbejtëve                                                  | 24,266    | 4,052  | 0    | 22,200            | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0      | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 50,518  |
| 04130 - Mbeshtetje për zhvillimin ekonomik                                    | 3,537     | 591    | 0    | 2,303             | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0   | 0      | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 6,431   |
| 04910 - Fondi Rezerve                                                         | 0         | 0      | 0    | 0                 | 0   | 0   | 0   | 0   | 2,000 | 0   | 0   | 0      | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 2,000   |
| 04940 - Fondi Kontigjence                                                     | 0         | 0      | 0    | 0                 | 0   | 0   | 0   | 0   | 2,000 | 0   | 0   | 0      | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 2,000   |


Raporti: PBA5 - Shpenzimet sipas Programit dhe Klasifikimit Ekonomik

NUJQV: 130 - Bashkia Malësi e Madhe

PBA: 2025 - 2027

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

|                                         |           | 2027              |     |         |     |     |     |     |     |       |     |                      |         |     |     |     |                   |         |  |       |
|-----------------------------------------|-----------|-------------------|-----|---------|-----|-----|-----|-----|-----|-------|-----|----------------------|---------|-----|-----|-----|-------------------|---------|--|-------|
| EMËRTIMI I PROGRAMIT                    | PERSONELI | KORRENTE TË TJERA |     |         |     |     |     |     |     |       |     | KAPITALE TËBRENDSHME |         |     |     |     | KAPITALE TË HUAJA |         |  | PLANI |
|                                         |           | 600               | 601 | 1661    | 602 | 603 | 604 | 605 | 606 | 609   | 651 | 230                  | 231     | 232 | 255 | 230 | 231               | 232     |  |       |
|                                         |           |                   |     |         |     |     |     |     |     |       |     |                      |         |     |     |     |                   |         |  |       |
| 06370 - Furnizimi me Uje dhe Kanalizime | 0         | 0                 | 0   | 0       | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 0     | 0   | 0                    | 0       | 0   | 0   | 0   | 0                 | 0       |  |       |
| Totali                                  | 389,315   | 64,677            | 0   | 203,135 | 0   | 0   | 0   | 0   | 0   | 4,000 | 0   | 0                    | 186,624 | 0   | 0   | 0   | 0                 | 847,751 |  |       |



Raportii: PBA8 - Projektet e Investimeve

NUVOV: 130 - Bashkia Malësi e Madhe

PBA: 2025 - 2027

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

| KODI                                           | EMËRTIMI I PROJEKTIT/PRODUKTIT                                           | BURIMI I FINANCIMIT  | DATA E FILLIMIT | DATA E PËRFUNDIMIT | KOSTO 2022 | 2023 | 2024 | 2025    | 2026    | 2027    |
|------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------|----------------------|-----------------|--------------------|------------|------|------|---------|---------|---------|
| Shpenzimet Kapitale sipas Projekteve           |                                                                          |                      |                 |                    |            |      |      |         |         |         |
| P111MA1                                        | Bashkefinancim Projekte                                                  | Financim i Brendshëm | 01/05/2024      | 30/11/2024         | 14,252     | 0    | 0    | 4,252   | 0       | 10,000  |
| P452MA1                                        | Sistemin Asfaltim Rrugesh                                                | Financim i Brendshëm | 01/06/2024      | 04/08/2025         | 533,511    | 0    | 0    | 241,075 | 127,943 | 67,700  |
| P813MA1                                        | Ndertim i Stadiumit te Koplikut                                          | Financim i Brendshëm | 01/12/2024      | 01/05/2026         | 139,273    | 0    | 0    | 43,280  | 21,487  | 37,253  |
| P637MA1                                        | Bashkefinancim Projekte                                                  | Financim i Brendshëm | 09/09/2024      | 31/12/2024         | 2,000      | 0    | 0    | 2,000   | 0       | 0       |
| Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Projekteve |                                                                          |                      |                 |                    | 689,036    | 0    | 0    | 290,607 | 149,430 | 114,953 |
| Shpenzimet Kapitale sipas Produkteve           |                                                                          |                      |                 |                    |            |      |      |         |         |         |
| 1                                              | Shërbimi i Staffit të Administrim & Menaxhim                             |                      |                 |                    | 0          | 0    | 0    | 4,520   | 0       | 10,000  |
| 10                                             | Raste të menaxhuara të zjarrit dhe shpëtimit                             |                      |                 |                    | 0          | 0    | 0    | 635     | 0       | 0       |
| 25                                             | Mirëmbajtja rutinë e kanaleve ujtëse dhe kanale kulluese                 |                      |                 |                    | 0          | 0    | 0    | 7,500   | 0       | 0       |
| 27                                             | Inspektim dhe kontroll i sipërfaqes pyjore/kullosore                     |                      |                 |                    | 0          | 0    | 0    | 3,596   | 0       | 0       |
| 69                                             | Objekte te arsimit baze dhe parashkollor të mirëmbajtura dhe funksionale |                      |                 |                    | 0          | 0    | 0    | 9,087   | 13,181  | 23,745  |
| 75                                             | Objekte te arsimit të mesëm të mirëmbajtura dhe funksionale              |                      |                 |                    | 0          | 0    | 0    | 27,493  | 6,484   | 19,133  |
| 82                                             | Familje dhe individë në nevojë që përfitojnë nga skema e NE              |                      |                 |                    | 0          | 0    | 0    | 72      | 0       | 0       |
| 38                                             | Depozitimi dhe trajtimi i mbejeve                                        |                      |                 |                    | 0          | 0    | 0    | 12,700  | 0       | 0       |
| Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Produkteve |                                                                          |                      |                 |                    | 0          | 0    | 0    | 65,603  | 19,665  | 42,878  |
| Totali i Përgjithshëm                          |                                                                          |                      |                 |                    | 0          | 0    | 0    | 356,210 | 169,095 | 157,831 |

RELACIONI I PËRGATITJES SË PROGRAMIT BUXHETOR  
AFATMESEËM VENDOR TE RISHIKUAR

2025 - 2027

BASHKIA MALESI E MADHE



## 1. Vështrim i përgjithshëm

### 1.1. Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore

Bashkia Malësi e Madhe ka ndërveprim ekonomik , infrastrukturor , social etj , me rajonin e Shkodrës dhe me Malin e Zi , duke krijuar kështu një lidhje shumë të ngushtë ndërmjet këtyre vendeve. Në pjesën perëndimore të Bashkisë , kalon aksi i rëndësishëm infrastrukturor dhe ekonomik , i cili lidh Podgoricën , duke kaluar në Malësinë e Madhe , për të vijuar me Shkodrën dhe duke vazhduar me Lezhën e Tiranën e më pas me Durrësin . Hekurudha që kalon në perëndim të rajonit të Malësisë së Madhe dhe lidhja që kjo hekurudhë ka me qytetin e Podgoricës ka potencialin për lidhje ndërkombëtare , edhe për udhëtim pasagjerësh Të dhënat urbane që gjenerohen nga PPV , do të ndihmonin në analizën e potencialit të përgjithshëm të industrisë së ndërtimit , në funksion të fondit publik dhe privat të banesave sociale , si dhe mungesën e këtij potenciali në Bashkinë Malësi e Madhe , për të cilën subvencionimi nga buxheti i shtetit është si domosdoshmëri .

Në linja të përgjithshme , problematikat që hasen menjëherë nga vizita në terren , janë mungesa e infrastrukturës rrugore ose cilësia e ulët e saj dhe ndërtimi pa kriter në mënyrë të përhapur . Analiza më e thelluar ka evidentuar problem të infrastrukturës inxhinierike , të përmbytjes nga liqeni , të shpyllëzimit dhe problematikave të tjera mjedisore , ndotje urbane për shkak të mungesës së vendgrumbullimit të kontrolluar të mbetjeve urbane dhe keqfunksionimit të sistemit të kanalizimeve . Zhvillimi i bujqësisë has vështirësi për shkak të mungesës së strukturave mbështetëse , si p.sh. mungesa e mirëmbajtjes së rrjetit të kanaleve dhe argjinaturave , rezervat e vogla ujore , erozioni , copëtimi i tokave bujqësore si dhe mungesa e hallkave të ndërmjetme të zinxhirit ekonomik prodhim – shitje . Territori i Bashkisë Malësi e Madhe , për shkak të pozicionit gjeografik dhe potencialeve të larta natyrore e turistike , ka mundësi për një zhvillim të qëndrueshëm në të ardhmen. Skenaret e zhvillimit ndihmojnë për të theksuar elementët e fortë territorial , për të përcaktuar hapat e zhvillimit që do të ndërmerren , me qëllim rritjen ekonomike të Bashkisë Malësi e Madhe . Duke iu referuar gjendjes ekzistuese , si dhe skenarit të menduar si më të favorshëm për zhvillimin e Bashkisë Malësi e Madhe , atë hierarkik është bërë kategorizimi i qendrave të banuara si më poshtë: Qendër primare – qyteti i Koplikut , Bajzës ; Qendra lokale turistike – Razëm , Reç , Tamarë , Lëpushë , Vermosh , Bogë etj ; Qendra lokale rurale – Gruemirë , Grizhë , Pjetrosan , Hot , Zagorë etj ; Si qendra sekondare propozohen dhe fshatra të tjerë , në të cilët do të aplikohen programe mbështetëse për të përmbysur trendin e braktisjes dhe nxitur rimëkëmbjen e ekonomisë . Orientimi kryesor i tyre do të jetë në drejtim të bujqësisë dhe turizmit rural . Lidhjet e infrastruktures ekzistuese do të përmirësohen dhe do të krijohen të reja , në shërbim të zhvillimit ku orientohen. Këto zona do të aksesohen nga transporti publik dhe hapësirat publike të qendrave të këtyre fshatrave do të sistemohen duke marrë karakterin e shesheve të fshatit si pika takimi të banorëve . Për rrjedhojë terësia e këtyre përmirësimeve do pasojë me rritjen e cilësisë së jetës në këto zona.

## 1.2. Çështje kryesore për projektet dhe politikat e Bashkisë/ Këshillit të Qarkut

Politika e Bashkisë është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata: • Rritja e transparencës ndaj komunitetit, bashkëpunimi dhe aktivizimi i tij deri në shkallën më të lartë të vendimmarrjes së përbashkët. • Krijimi i kushteve për të thithur investime bazuar në studime dhe projekte konkrete për përmirësimin e infrastrukturës, për të plotësuar kështu nevojat e biznesit, industrisë dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës. • Sigurimi, përmirësimi, standartizimi dhe lehtësimi i shërbimeve të Bashkisë që t'ju përshtatet nevojave të komunitetit me më shumë efektivitet. • Krijimi i kushteve të domosdoshme për përmirësimin e mëtejshëm të shërbimit arsimor, kulturor, sportiv dhe shëndetsor. • Krijimi i hapësirave të cilat stimulojnë gjallërimin e bizneseve të reja. • Mbajtja e vendeve ekzistuese të punës dhe nxitja e investimeve për të hapur vende të reja pune • Vlerësimin e projekteve dhe lidhjen e tyre me programet e shpenzimeve publike • Cilësi e lartë e jetesës dhe zhvillimin urban

## 1.3. Informacion financiar kryesor

Hartimi i projektit buxhetor afatmesëm 2025-2027 është bërë bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", ligjin 68/2017 datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV", ne udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8 datë 5.07.2024 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027" dhe shtojcat plotësuese (Shtojcat e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 si informacion mbi nivelin e transfertës së pakushtëzuar dhe specifike për njësitë e vetëqeverisjes vendore, formati i përgatitjes së relacionit shoqerues së programit buxhetor afatmesëm 2025-2027, formati për treguesit orientues të performancës për çdo program, Grupi për menaxhimin Strategjik / Ekipi i Menaxhimit të programit si dhe roli i tyre, treguesit makroekonomik e fiskale, pema e programit si dhe Instrumenti i planifikimit të programit buxhetor afatmesëm për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Bashkëlidhur ju paraqesim, për njohje dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2025-2027. Hartimi i Buxhetit për vitet 2025 - 2027 është kryer pas një pune gjithëpërfshirëse të administratës së Bashkisë, anëtarëve të Këshillit të Bashkisë, Njësise Administrative, komunitetin e biznesit, komunitetin e banoreve, si dhe aktore të ndryshëm të shoqërisë civile. Përgatitja e buxhetit është paraprirë nga dëgjesa dhe komunikim me publikun, Promovimi i transparencës në krijimin e instrumenteve financiarë ndaj komunitetit përbën një detyrim ligjor për organet shtetërore, por në fakt është edhe një detyrim moral që kanë institucionet e qeverisjes vendore ndaj komunitetit që përfaqësojnë. Hartimi i Buxhetit u përfshi në një cikël të plotë buxhetimi sipas kërkesave ligjore, duke i ndjekur të gjitha hapat të përcaktuara në ligj. Administrata e Bashkisë është bazuar kryesisht ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", si dhe ligjin nr.146/2014 "Për konsultimin publik", përveç akteve ligjore dhe nënligjore teknike dhe specifike të sipërcituara të domosdoshëm për hartimin e këtij instrumenti financiar.

Ky projekt buxhet është një instrument i rëndësishëm financiar që përveçse të promovojë transparencën, duhet të ketë një impakt të gjerë në Bashkinë Malesi e Madhe, duke përfaqësuar qoftë zonat urbane, qoftë zonat rurale që janë bashkuar në kuadër të reformës territoriale, si dhe të rikthejë mbrapsht në shërbime e investimeve të ardhurat e mbledhura nga komuniteti në formën e taksave dhe tarifave vendore. Planet e shpenzimeve për çdo program janë hartuar brenda burimeve që Bashkia ka në dispozicion (sipas kalendarit të miratuar më parë mbi përgatitjen e PBA). Ky dokument përdoret për të informuar Këshillin Vendor dhe publikun e gjerë lidhur me planet e shpenzimeve të Bashkisë për tre vitet e ardhshme, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave politike të Qeverisjes Vendore. Ai përcakton kontekstin afatmesëm të Buxhetit Vjetor. Buxheti total i Bashkisë Malesi e Madhe për vitin 2025 është 788,816 mijë lekë, për vitin 2026 është planifikuar 818,958 mijë lekë dhe për vitin 2027 është planifikuar 847,751 mijë lekë. Financimi i buxhetit realizohet nga:

- Burimet e veta vendore ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore dhe të ardhura të tjera të bashkisë, përfshirë edhe trashëgiminë nga viti i shkuar. Të ardhurat e veta zënë mesatarisht 10.5% të të ardhurave të përgjithshme të bashkisë për vitin 2025, 10.3% të të ardhurave të përgjithshme të bashkisë për 2026 dhe 10% për vitin 2027.

#### 1.4. Strategjia e zhvillimit afatgjatë

Realizimi i vizionit të Bashkisë kalon në disa hallka, të cilat për të mos humbur fokusin duhet të jenë të mirë strukturuara, si në renditje ashtu edhe në shtrirjen kohore. Kështu, vizioni bëhet i zbatueshëm duke përcaktuar objektiva të cilat detajohen në programe dhe projekte. Detajimi i vizionit të Bashkisë Malesi e Madhe bazohet në objektivat e mëposhtëm: OB\_1 Zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm dhe përdorimi me ndërgjegje i burimeve natyrore Bashkia Malesi e Madhe, e bazon zhvillimin ekonomik të saj në disa shtylla, të cilat krijojnë edhe të ardhurat kryesore për banorët e Malesisë së Madhe. Këto shtylla, duhet të promovohen dhe mbështeten që të krijohet një mirëfunksionim dhe zinxhir ekonomik në të gjithë territorin e Bashkisë. Në këtë mënyrë, bazuar në mbështetjen dhe fuqizimin e bujqësisë, blegtorisë, peshkimit, ekonomisë pyjore dhe turizmit, vlen të përmenden edhe mbështetja me infrastrukturë dhe pika magazinimi, me ritjen e sipërfaqes së punuar dhe prodhimit, me rritjen e prodhimit blegtoral, me fuqizimin e aktiviteteve ekonomike, prodhuese dhe magazinuese në funksion të ekonomisë lokale dhe rajonale, me zhvillimin dhe promovimin e shërbimeve turistike liqenore dhe malore, me administrimin dhe monitorimin e zhvillimit ekonomik rajonal. Zhvillimi i prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe tregtimit të bimëve mjeksore eterovajore dhe aromatike; Zhvillimi i prodhimit, grumbullimit, ruajtjes, përpunimit dhe tregtimit të perimeve të hershme në zonën fushore dhe perimeve të vona në zonën kodrinore –malore; Zhvillimi i prodhimit, grumbullimit, përpunimit dhe tregtimit të pemëve frutore, gështenjës, aroreve dhe vreshtarisë. OB\_2 Përmirësimi i kushteve të vendbanimeve ekzistuese me qëllim frenimin e fenomenit të migrimit Qytetet dhe fshatrat e territorit të bashkisë, bazuar në vendndodhjen e tyre në territory, kategorizohen si vendbanime fushore dhe malore, duke ndryshuar nga vlerat arkitektonike lokale. Është e rëndësishme që kushtet e vendbanimeve dhe shërbimeve, duke i sistemuar këto struktura dhe vendosur rregulla specifike bazuar në zonën ku gjenden. Qytetet – me rëndësi të fuqizohen dhe përmirësohen kushtet e vendbanimeve dhe shërbimeve, duke i strukturuar vendbanimet, zhvilluar infrastrukturën e transportit rrugor e hekurudhor dhe siguruar lëvizshmërinë për

të gjithë qytetarët . Fshatrat – zona të mirëfillta rurale ku nxitet projektimi i hapësirave publike dhe objekteve bazuar në element të traditës për të theksuar karakterin dhe për t'u orientuar drejt turizmit rural e agroturizmit . Në fshatra do të aplikohen programe mbështetëse për të nxitur rimëkembjen e ekonomisë . Lidhjet infrastrukturore ekzistuese do të përmirësohen dhe do të krijohen të reja , në shërbim të zhvillimit ku orientohen . Këto zona do të aksesohen nga transporti publik dhe hapësirat publike të qëndrave të këtyre fshatrave do të sistemohen , duke marrë karakterin e shesheve të fshatit , si pika takimi të banorëve . Në të gjithë territorin do të konsiderohet edhe përmirësimi i kushteve si : krijimi i shërbimit hidrik të integruar , mjedis i pastër dhe i sigurt natyror , furnizimi me energji , krijimi dhe integrimi i sistemit të komunikimit , rritja në standarte dhe cilësi e strukturave dhe shërbimeve parashkollë , arsimore , shëndetësore e sociale , krijimi i kushteve për zhvillimin e jetës social-kulturore , rekreative dhe sportive . OB-3 Ruajtja e resurseve natyrore , trashëgimisë kulturore dhe promovimi i tyre si vlerë e shtuar turistike Ndër vlerat më kryesore të territorit të bashkisë është prezenca e resurseve natyrore , jo vetëm bukuri natyrore , por edhe vlerat e larta të shtuara drejt turizmit dhe të ardhurat e bashkisë . Primare për këto resurse natyrore është ruajtja dhe promovimi i tyre , për të mbështetur zhvillimin e këtyre territoreve . Duke realizuar zhvillimin e zonave të parqeve , elementët natyrorë të zonës do të bëhen pjesë aktive e komunitetit dhe të turistëve , duke evidentuar dhe promovuar trashëgiminë kulturore , historike e arkitektonike të Malësisë së Madhe , në mbështetje të shtimit të cilësisë dhe llojshmërisë së ofertës turistike për vizitorët . Malësia e Madhe si pjesë e Parkut Ballkanik të Paqes , është konsideruar si vlera më e rëndësishme e shtuar për këtë territor , duke marrë parasysh krijimin e akteve të shtigjeve kulturore dhe natyrore në territor , rrjetin infrastrukturor për këmbësorë dhe krijimin e ofertave turistike . Ndërtimi i infrastrukturës në funksion të ruajtjes të ruajtjes dhe promovimit të vlerave mjedisore për territorin e Bashkisë Malësi e Madhe.

#### 1.5. Sfidat kryesore të zhvillimit/ Paraqitja e projekteve kryesore – arsyet dhe përfituesit

Menaxhimi i burimeve natyrore Shërbimet bujqësore Përmirësimi i aksesit në zonat rurale me qëllim zbutjen e pabarazive dhe ofrimin e shërbimeve administrative në të gjithë territorin e Bashkisë Menaxhimi i burimeve ujore Shërbimet publike vendore Inkurajimi i efektivitetit dhe efikasitetit në kryerjen e shpenzimeve publike Lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve strategjiko-politike të Qeverisjes Vendore me shpërndarjen e burimeve dhe kryerjen e shpenzimeve publike Zhvillimi ekonomik me theks në mjedis mjedisit në mënyrë që të garantohet mbrojtja e ekosistemeve dhe vlerave të shumta natyrore. Boshtet kryesore të zhvillimit ekonomik do të jenë zhvillimi rural (bujqësia dhe blegtoaria), turizmi, industria e lehtë/përpunimi, shërbimet, dhe ekonomia e të ardhmes e bazuar në sistemet e teknologjisë së informacionit Integrimi i brezave të rinj në ekonomi, dhe krijimin e mundësive për iniciativat në kuadër të rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

Te dhena baze mbi Bashkinë Malësi e Madhe

Bashkia Malesi e Madhe ka nje shtrirje territoriale prej 951 km<sup>2</sup> , dhe ka 6 njesi administrative , numri i banoreve ,numri total i punonjesve ne Bashkine e Malesise se Madhe, si dhe numri i punonjesve te administrates jane pasqyruar sipas viteve ne tabelen si me poshte:

Të Dhëna Bazë mbi Bashkinë

|                                                | Të Pergjithshme | 2023   | 2024   | 2025   | 2026   | 2027   |
|------------------------------------------------|-----------------|--------|--------|--------|--------|--------|
| Numri i Njësive Administrative                 | 6               |        |        |        |        |        |
| Numri i Fshatrave                              |                 |        |        |        |        |        |
| Sipërfaqja e Bashkisë (km <sup>2</sup> )       | 951             |        |        |        |        |        |
| Qyteti                                         |                 |        |        |        |        |        |
| Njësiti Administrative                         |                 |        |        |        |        |        |
| Sipërfaqja e Bashkisë (km <sup>2</sup> )       | 951             |        |        |        |        |        |
| Zonë Urbane                                    | -               |        |        |        |        |        |
| Tokë Bujqësore                                 | -               |        |        |        |        |        |
| Kullota                                        | -               |        |        |        |        |        |
| Pyje                                           | -               |        |        |        |        |        |
| Popullsia e Bashkisë                           |                 | 56,347 | 56,024 | 56,000 | 56,000 | 56,000 |
| Numri i punonjësve të bashkisë                 |                 | 502    | 506    | 506    | 506    | 506    |
| Numri i punonjësve në administratën e bashkisë |                 | 138    | 146    | 146    | 146    | 146    |

#### 1.6. Plani i shpenzimeve kapitale 2025 – 2027

Disa nga projektet kryesore te PBA-se 2025- 2027

Projektet e investimeve jane pasqyruar ne tabelen projekteve te investimeve , ku per vitin 2024 buxheti i investimeve eshte ne vleren 354,210 mije leke , per vitin 2025 jane parashikuar projektet ne vleren 169,095 mije leke ,per vitin 2026 jane parashikuar 157,831 mije leke dhe per vitin 2027 jane parashikuar projektet ne vlere 186,624 mije leke.



## 2. Informacion financiar

### 2.1. Burimi i të ardhurave

Buxheti I Bashkise per vitet 2025-2027 ku hyjne te ardhurat nga transferta e pakushtezuar, transferta sektoriale, transfertat e deleguara dhe te ardhurat e veta vendore te Bashkise sipas viteve parashikohen respektivisht per vitin 2025 , 2026 dhe per vitin 2027 paraqiten ne tabelen si me poshte:

|                                       | 2025             | 2026             | 2027             |
|---------------------------------------|------------------|------------------|------------------|
|                                       | Plani            | Plani            | Plani            |
| Te Ardhurat nga Burimet e Veta        | 161,326          | 164,552          | 164,552          |
| Transferta e pakushtëzuar             | 413,231          | 438,456          | 465,541          |
| Transferta e pa kushtëzuar sektoriale | 214,259          | 215,950          | 217,658          |
| Transfertat e deleguara               | 294,543          | 315,161          | 315,161          |
| Trashegimi nga viti I shkuar          | 0                | 0                | 0                |
| <b>TOTALI</b>                         | <b>1,083,359</b> | <b>1,134,119</b> | <b>1,162,912</b> |



Taksat dhe tarifat vendore te Bashkise jane paraqitur ne tabelen si me poshte:

[illegible]

Ne territorin e Bashkise Malesi e Madhe ushtrojne aktivitetin rreth 361 biznese te vogla, 38 biznese me tvsh, 125 biznese te Medha, dhe paguajne taksa familjare 16,674 familje.



Taksa mbi ndertesat per vitin 2025 eshte 18,686 mije leke, per vitin 2026 eshte 19,060 mije leke dhe per vitin 2027 eshte 19,060 mije leke, dmth per vitin 2025 eshte bere rritje me 1% nga viti 2024, kurse per vitin 2026 eshte lene 19,060 mije ne te njejtin nivel me vitin 2027.

Taksa mbi token bujqesore per vitin 2025 eshte 5,046 mije leke, per vitin 2026 eshte 5,147 mije leke dhe per vitin 2027 eshte 5,147 mije leke, eshte bere rritje per vitin 2025, 1% nga viti 2024 kurse per vitin 2026 eshte lene ne te njejtin nivel me vitin 2027.

Taksa mbi truallin per vitin 2025 eshte 2,497 mije leke, per vitin 2026 eshte 2,547 mije leke dhe per vitin 2027 eshte 2,547 mije leke. Per vitin 2025 eshte bere rritje 1% nga viti 2024, kurse per vitin 2027 eshte lene ne te njejtin nivel me vitin 2026.

Edhe taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja per vitin 2025 eshte ne vlere 34,212 mije leke eshte bere rritje me 1 % ne krahasim me vitin 2024, per vitin 2026 eshte ne vlere 34,895 mije leke dhe per vitin 2027 e njejte me vitin 2026.

Edhe tarifa e pastrimit per vitin 2025 eshte 27,530 mije leke, me rritje 1,4% nga viti 2024, Kurse per vitin 2026 eshte 28,081 mije leke ,per vitin 2027 eshte ne te njejtin nivel me vitin 2026.

Pra sipas tabelës se te ardhave tarifave dhe taksat kane rritje per vitin 2025, 1% nga viti 2024 kurse per vitin 2026 kane rritje 1% nga Viti 2025 dhe viti 2027 eshte te njejtin nivel me vitin 2026.

SPECIALISTE BUXHETIT  
Violeta Zekaj



DREJTOR I FINANCES DHE BUXHETIT  
Altin Rrukaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCEVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT  
DREJTORIA E FINANCEVE VENDORE

Nr. 9436 Prot.

Tiranë, më 5/07/2024

UDHËZIM PLOTËSUES

Nr. 8 Datë 5/07/2024

**“PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM VENDOR 2025-2027”**

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar, Ministri i Financave:

**UDHËZON**

- I. Tavanet përfundimtare të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027
- Tavanet përfundimtare të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2025-2027, të miratuara nga Këshilli i Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore do të merren në konsideratë për hartimin e buxhetit të vitit 2025.
  - Parashikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore do të mbështetet në legjislacionin aktual në lidhje me taksat dhe tarifat vendore, si dhe në ligjin nr.68 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ndryshuar.
  - Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe transfera të pakushtëzuar sektoriale për vitin 2025, do të jenë në përputhje me nivelin e financimit të miratuar në Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal 2025-2027, sipas detajimit të parashikimit të dërguar në fazën e parë të PBA-së për vitet 2025-2027. Efekti i rritjes së pagave për funksionet e financuara me transfertë sektoriale dhe për punonjësit e administratës së bashkisë do të reflektohet në transfertën që do ti akordohet njësive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2025.

- Niveli i transfertës së pakushtëzuar dhe i transfertës së pakushtëzuar sektoriale për vitet 2025-2027, (së bashku me të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore), financo funksionet dhe kompetencat që janë transferuar në pushtetin vendor deri në vitin 2024. Për transferimin e funksioneve që mund të bëhen në të ardhmen niveli i transfertës së pakushtëzuar/pakushtëzuar sektoriale do të shtohet në varësi të funksioneve ose kompetencës së transferuar dhe faturës financiare përkatëse.
- Kuadri Makroekonomik dhe Fiskal 2025-2027 i miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 41 datë 24.01.2024, përcakton kontekstin ekonomik për Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027. Ai pasqyron parashikime të treguesve ekonomik dhe financiar të buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore për tre vitet e ardhshme, duke ofruar vlerësime të burimeve që njësia e vetëqeverisjes vendore do të ketë në dispozicion për të financuar shpenzimet e saj.
- Këto vlerësime sigurojnë bazën për njësitë e vetëqeverisjes vendore për të përcaktuar tavanet e shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm.
- Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore duhet të përfshijnë në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 planin e shlyerjes së detyrimeve të prapambetura.
- Procesi i miratimit të PBA-së 2025-2027 përfundimtare dhe Buxhetit Vjetor, do të realizohet nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor.
- Programi Buxhetor Afatmesëm 2025-2027 duhet të hartohet në përputhje me programet e miratuara me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar.
- Bashkitë: Korçë, Gjirokastrë, Mirditë, Berat, Devoll, Elbasan, Lezhë, Lushnjë, Përmet, Shkodër, Shijak dhe Belsh, do të vijojnë me fazën e dytë të PBA-së sipas sipas metodologjisë së re të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave nr.3 datë 28.02.2024.

## II. Afatet për Përgatitjen e Buxhetit

- Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga buxheti i shtetit, kryetari i njësive të vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësive të vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi.
- Këshilli i njësive të vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik.
- Brenda datës 15 shtator, njësia e vetëqeverisjes vendore dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar, të miratuar nga këshilli i njësive, së bashku me një informacion mbi rekomandimet e dhëna nga Ministria e Financave gjatë fazës së parë.
- Ministria e Financave zhvillon seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 tetor. Në përfundim të këtyre takimeve, sipas rastit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final të programit buxhetor afatmesëm, brenda datës 20 tetor.

### III. Mbështetja Këshillimore për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore

- Ministria e Financave, në kuadër të mbështetjes këshillimore për përgatitjen e PBA 2025-2027, vë në dispozicion për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore adresat e e-mailit: [Fran.Brahimi@financa.gov.al](mailto:Fran.Brahimi@financa.gov.al), [Elidona.Durmishi@financa.gov.al](mailto:Elidona.Durmishi@financa.gov.al).
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund ti drejtohen në çdo kohë Ministrisë së Financave për zgjidhjen e çdo problematike që shfaqet në lidhje me hartimin e programit buxhetor afatmesëm dhe plotësimin e formateve të PBA-së në fazën e dytë dhe fazën përfundimtare sipas Sistemit të Menaxhimit të Buxhetit Vendor.

